



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Raporti i Auditimit të Pajtushmërisë

**“MENAXHIMI DHE MONITORIMI I
SUBVENCIONEVE NË FUSHËN E SPORTIT
NË KOMUNËN E PRISHTINËS PËR
PERIUDHËN 01-01-2024- 31-12-2025”**

TABELA E PËRMBAJTJES

PJESA I. PËRMBLEDHJA E PËRGJITHSHME	3
PJESA II. LËNDA E AUDITUAR DHE FUSHËVEPRIMI	4
1.1. TITULLI DHE ENTITETI I AUDITUAR.....	4
1.2. PERIUDHA E AUDITIMIT	4
1.3. ARSYESHMËRIA DHE BAZA LIGJORE PËR KRYERJEN E AUDITIMIT	5
1.4. STANDARDET E PËRDORURA TË AUDITIMIT	5
1.5. PËRSHKRIMI I LËNDËS SË AUDITIMIT DHE FUSHËVEPRIMIT TË AUDITIMIT	5
1.6. OBJEKTIVAT E AUDITIMIT	5
1.7. KRITERET E AUDITIMIT	6
PJESA III. GJETJET	6
PJESA IV. KONKLUZIONET.....	13
PJESA V. REKOMANDIMET	14
PJESA VI. PËRGJIGJET NGA ENTITETI I AUDITUAR	15

Zyra Kombëtare e Auditimit, në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik kryen auditime vjetore financiare dhe pajtueshmërisë të detyrueshme me ligj dhe auditime të performancës.

ZKA përmes auditimeve ofron informacion cilësor mbi përdorimin e fondeve publike të cilat ndihmojnë entitetet e audituara të përmirësojnë sistemet e tyre të menaxhimit financiar dhe kontrollit, duke rritur transparencën dhe llogaridhënien, parandalimin e korrupsionit dhe përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të fondeve publike. Njëkohësisht, kjo do t'i shtojë vlerë veprimtarisë së tyre operative dhe strategjike. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ne përmes raporteve të auditimit kemi ofruar një pamje të qartë se si qeveria dhe institucionet publike kanë menaxhuar me shpenzimet dhe të ardhurat, pasurinë publike dhe qeverisjen në nivel të vendit.

Ne kemi vlerësuar pajtueshmërinë e procesit të ndarjes, menaxhimit dhe monitorimit të subvencioneve në fushën e sportit, si dhe efektivitetin e kontrolleve të brendshme të vendosura nga Komuna e Prishtinës për të siguruar përdorimin e rregullt dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi të fondeve publike.

Fushë me rëndësi të cilës Zyra Kombëtare e Auditimit i kushton vëmendje është edhe menaxhimi dhe monitorimi i subvencioneve në fushën e sportit, duke pasur parasysh ndarjen e fondeve publike për këtë qëllim dhe rëndësinë e kësaj fushe për zhvillimin e aktiviteteve sportive dhe interesin publik. Auditimi synon të kontribuojë në rritjen e transparencës, llogaridhënies dhe pajtueshmërisë në menaxhimin e këtyre fondeve publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA 4000). Auditimet e pajtueshmërisë të ndërmarra nga Zyra Kombëtare e Auditimit janë shqyrtime objektive dhe të besueshme që vlerësojnë nëse veprimet qeveritare, sistemet, operacionet, programet, aktivitetet ose organizatat veprojnë në përputhje me autoritetet.

Auditorja e Përgjithshme ka vendosur në lidhje me përmbajtjen e raportit të auditimit “Menaxhimi dhe Monitorimi i subvencioneve në fushën e sportit në Komunën e Prishtinës për periudhën 01-01-2024- 31-12-2025”

Përbërja e ekipit të auditimit:

Blerim Kabashi, Drejtor i departamentit të auditimit;

Ganimete Dalloshi Hoxhaj, Udhëheqëse e ekipit;

Fanol Hodolli, Anëtar i ekipit;

Valmira Jonuzi, Anëtare e ekipit;

Refiqe Morina Anëtare e ekipit; dhe

Alban Shatri, Anëtar i ekipit

PJESA I. PËRMBLEDHJA E PËRGJITHSHME

Zyra Kombëtare e Auditimit ka kryer auditimin e pajtueshmërisë me temën "Menaxhimi dhe monitorimi i subvencioneve në fushën e sportit në Komunën e Prishtinës". Objektivi i këtij auditimi është të vlerësojë nëse procesi i ndarjes, menaxhimit dhe monitorimit të subvencioneve në fushën e sportit është zhvilluar në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe nëse janë vendosur kontrole të mjaftueshme për të siguruar përdorimin e rregullt të fondeve publike.

Subjekt i auditimit ishte Komuna e Prishtinës, përkatësisht procesi i menaxhimit dhe monitorimit të subvencioneve në fushën e sportit për periudhën janar 2024 deri në dhjetor 2025.

Në vitin 2024, komuna kishte planifikuar 826,108€ subvencione për rini dhe sport dhe 825,000€ në vitin 2025. Shpenzimet për vitin 2024 ishin 819,674€, ndërsa për vitin 2025 ishin 138,929€.

Konkluzioni i auditimit është se Komuna e Prishtinës nuk ka arritur të sigurojë menaxhim dhe monitorim efektiv të subvencioneve në fushën e sportit.

Komuna procesin e financimit e kishte zhvilluar pa kritere dhe prioritet të përcaktuara paraprakisht, ndërsa në tetë raste subvencionet ishin ndarë pa thirrje publike vetëm me vendim të Kuvendit Komunal. Gjithashtu, gjatë vlerësimit të aplikimeve janë identifikuar raste të përfituesve që nuk i plotësonin të gjitha kriteret e thirrjes publike. Po ashtu, komuna nuk kishte vendosur mekanizma efektiv për monitorimin e zbatimit të projekteve dhe sigurimin e dorëzimit të raporteve narrative e financiare nga përfituesit. Si rezultat, janë identifikuar dobësi që ndikojnë në transparencën, llogaridhënien dhe përdorimin e rregullt të fondeve publike.

Për të eliminuar mangësitë e identifikuara, kërkohen veprime konkrete dhe për këtë kemi dhënë gjashtë rekomandime për Komunën e Prishtinës.

PJESA II. LËNDA E AUDITUAR DHE FUSHËVEPRIMI

1.1. KOMUNA E PRISHTINËS

Komuna e Prishtinës është njësia më e madhe e vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës, e cila ushtron kompetencat e saj në përputhje me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale dhe legjislacionin tjetër në fuqi. Në kuadër të kompetencave të saj, komuna planifikon dhe zbaton politika për zhvillimin lokal, duke ofruar shërbime publike dhe duke mbështetur zhvillimin ekonomik, social, kulturor dhe sportiv të qytetit. Përmes buxhetit komunal, ajo financo organizata joqeveritare, klube dhe aktivitete sportive me qëllim të promovimit të sportit, rritjes së pjesëmarrjes së qytetarëve në aktivitete sportive dhe mbështetjes së zhvillimit të sportit në nivel lokal.

Procesi i ndarjes dhe monitorimit të subvencioneve në fushën e sportit administrohet nga Drejtoria për Sport, e cila është përgjegjëse për planifikimin e fondeve, organizimin e thirrjeve publike, vlerësimin e aplikimeve, lidhjen e marrëveshjeve me përfituesit, monitorimin e zbatimit të projekteve dhe shqyrtimin e raporteve narrative dhe financiare të përfituesve. Në këtë proces përfshihen edhe komisionet e vlerësimit të aplikimeve dhe zyrtarët përgjegjës për monitorimin e realizimit të projekteve të financuara.

Gjatë periudhës 2024–2025, Komuna e Prishtinës ka planifikuar fonde për financimin e subvencioneve në fushën e sportit. Në tabelën në vijim janë paraqitur të dhënat lidhur me buxhetin e planifikuar dhe realizimin e shpenzimeve për këtë periudhë.

Tabela përfshinë buxhetin e planifikuar dhe shpenzuar për subvencione për Rini dhe Sport

Viti	Buxheti i planifikuar (€)	Shpenzimet e realizuara (€)
2024	826,108€	819,674€
2025	825,000€	138,929€

1.2. PERIUDHA E AUDITIMIT

Periudha e auditimit mbulon 01-01-2024- 31-12-2025.

1.3. ARSYESHMËRIA DHE BAZA LIGJORE PËR KRYERJEN E AUDITIMIT

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) ka mandat kushtetues dhe ligjor, për t'i audituar programet dhe projektet e menaxhuara nga organizatat buxhetore dhe të financuara nga buxheti i Kosovës. Auditimi kryhet në bazë të paragrafi 2, nenit 21, të Ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës.

1.4. STANDARDET E PËRDORURA TË AUDITIMIT

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130 Kodin e Etikës, 400 Parimet e auditimit të pajtueshmërisë, dhe 4000 Standardet e auditimit të pajtueshmërisë dhe manuali i auditimit financiar dhe të pajtueshmërisë së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e pajtueshmërisë, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Dëshmitë e auditimit të mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të mbështetur konkluzionet e nxjerra në këtë raport.

1.5. PËRSHKRIMI I LËNDËS SË AUDITIMIT DHE FUSHËVEPRIMIT TË AUDITIMIT

Ky auditim ka përfshirë procesin e planifikimit, menaxhimit dhe monitorimit të subvencioneve në fushën e sportit në Komunën e Prishtinës, duke vlerësuar nëse:

- Planifikimin e subvencioneve në fushën e sportit;
- Procesin e ndarjes së subvencioneve; dhe
- Monitorimin dhe raportimin për zbatimin e projekteve të financuara.

Gjatë këtij auditimi nuk kemi pasur kufizime që do të ndikonin në punën tonë audituese.

Auditimi ka përfshirë periudhën 1 janar 2024 deri më 31 dhjetor 2025 dhe është zhvilluar në Komunën e Prishtinës, përkatësisht në Drejtorinë përgjegjëse për sportin dhe njësitë tjera të përfshira në procesin e ndarjes dhe monitorimit të subvencioneve.

1.6. OBJEKTIVAT E AUDITIMIT

Objektivi i auditimit ishte të vlerësojë pajtueshmërinë e vendimeve dhe aktiviteteve të menaxhmentit me kërkesat e kuadrit ligjor dhe rregullativ, aktet e brendshme dhe marrëveshjet e lidhura në fushën e audituar: “Menaxhimi dhe monitorimi i subvencioneve në fushën e sportit në Komunën e Prishtinës”, përkatësisht të vlerësojë:

- Nëse planifikimi i subvencioneve është kryer në përputhje me buxhetin e miratuar dhe kërkesat ligjore;
- Nëse procesi i ndarjes dhe pagesës së subvencioneve është zhvilluar në përputhje me legjislacionin, vendimet dhe marrëveshjet përkatëse; dhe
- Nëse komuna ka vendosur kontrole të përshtatshme për monitorimin e projekteve dhe nëse raportet narrative e financiare janë dorëzuar, shqyrtuar dhe dokumentuar.

Qëllimi i auditimit është të ofroj rekomandime për përmirësimin e menaxhimit dhe monitorimit të subvencioneve në fushën e sportit.

1.7. KRITERET E AUDITIMIT

Kriteret e auditimit bazohen në pajtueshmërinë me:

- Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale
- Ligji Nr. 04/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, me ndryshimet dhe plotësimet ligjore të mëvonshme;
- Ligji Nr. 08/L-260 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024;
- Ligji Nr. 08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025;
- Rregullorja MF-NR-04/201 Mbi kriteret, Standardet dhe procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve;
- Rregullorja Nr. 01-020/01-194101/18 për ndarjen e subvencioneve nga Komuna e Prishtinës (datës 08.08.2018);
- Rregullorja Nr. 01-011/01-79067/25 për ndarjen e subvencioneve nga Komuna e Prishtinës (datës 04.06.2025); dhe
- Thirrjet publike, vendimet për ndarjen e subvencioneve, marrëveshjet/kontratat me përfituesit dhe dokumentacioni mbështetës për vitet 2024 dhe 2025.

PJESA III. GJETJET

ZKA ka identifikuar mangësi në procesin e menaxhimit dhe monitorimit të subvencioneve në fushën e sportit nga ana e Komunës së Prishtinës. Mangësitë e identifikuar pasqyrohen përmes gjetjeve të auditimit, të cilat reflektojnë dobësi në planifikimin e subvencioneve, zhvillimin e procedurave për ndarjen e tyre, monitorimin e zbatimit të projekteve, si dhe raportimin dhe mbikëqyrjen e përdorimit të fondeve publike. Gjetjet e auditimit bazohen në analizën e dokumentacionit relevant të siguruar nga Komuna e Prishtinës, si dhe në dëshmitë e mbledhura gjatë procesit të auditimit. Në vijim paraqiten çështjet e identifikuar:

Çështja 1 - Procesi i vlerësimit të aplikimeve pa kriteret e qarta të vlerësimit dhe metodologji të përcaktuar paraprakisht

Kriteri:

Sipas nenit 4 të Rregullores MF Nr. 04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, financimi publik i OJQ-ve duhet të bazohet në parimet e konkurrueshmërisë, trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit, transparencës në procedura dhe vendimmarrje gjatë gjithë ciklit të ofrimit të mbështetjes financiare, duke përfshirë publikimin e kriterëve dhe procedurave, si dhe në kriteret të përcaktuara paraprakisht që mundësojnë vlerësimin e propozimeve të aplikuesve kundrejt objektivave dhe prioriteteve të mbështetjes financiare. Po ashtu, sipas Manualit për Implementimin e Rregullores MF-Nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, Komisioni Vlerësues duhet të shqyrtojë dhe vlerësojë përmbajtjen e aplikacioneve duke përdorur formularin standard të vlerësimit – Formularin F15, i cili është pjesë përbërëse e Manualit.

Gjendja:

Në thirrjet publike nr. 16-030/03-52830/24, të vitit 2024, dhe nr. 16-016/01-67191/25, të vitit 2025, për ofrimin e mbështetjes financiare në fushën e sportit dhe rinisë, ishin përcaktuar fushat e mbështetjes dhe kriteret e përgjithshme të pjesëmarrjes/pranueshmërisë. Megjithatë, nuk ishin përcaktuar dhe publikuar paraprakisht kriteret e detajuara për vlerësimin përmbajtësor dhe konkurrues të aplikimeve. Si rrjedhojë, procesi i vlerësimit dhe përzgjedhjes së përfituesve nuk mbështetej në një metodologji të dokumentuar që mundësonte vlerësimin e njëtrajtshëm dhe të krahasueshëm të aplikimeve. Gjithashtu, nuk ishte përdorur metodologji, formular i standardizuar vlerësimi (F15) apo sistem i pikëzimit, mbi bazën e të cilit do të vlerësoheshin aplikimet dhe do të bëhej renditja e përfituesve për financim.

Shkak:

Kjo ka ndodhur si rezultat i mungesës në kontrollet e brendshme, të cilat nuk kanë siguruar zhvillimin e procesit të vlerësimit dhe përzgjedhjes në përputhje me kërkesat ligjore.

Ndikimi:

Mungesa e kriterëve dhe prioriteteve të përcaktuara paraprakisht, si dhe moszbatimi i tyre gjatë procesit të vlerësimit, cenon parimet e konkurrueshmërisë, transparencës dhe trajtimit të barabartë të aplikuesve. Si rezultat, rritet rreziku që përzgjedhja e përfituesve të mos jetë objektive, e dokumentuar dhe e bazuar në kriteret e qarta.

Rekomandimi:

Komuna duhet të sigurojë që, para shpalljes së thirrjeve publike për financimin e OJQ-ve, të hartohen, miratohen dhe publikohen kriteret dhe prioritetet e financimit. Gjithashtu, duhet të sigurohet që komisionet vlerësuese të përdorin metodologji dhe formularë të standardizuar vlerësimi, përmes të cilëve dokumentohet vlerësimi i aplikimeve dhe përzgjedhja e përfituesve, në përputhje me kërkesat e Rregullores MF Nr. 04/2017.

Çështja 2 - Subvencionimi i OJQ-ve pa thirrje publike

Kriteri:

Sipas nenit 2.1 të Rregullores MF-Nr. 04/2017 – Mbi kriteret, standardet e financimit publik të Organizatave Jo Qeveritare (OJQ) parashihet që, financimi i projekteve dhe programeve të OJQ-ve bëhet sipas një thirrje publike, dhe të cilat i plotësojnë kriteret e Rregullores.

Gjendja:

Gjatë viteve 2024 dhe 2025, Komuna kishte ndarë subvencione për organizata dhe klube sportive jashtë procedurës së thirrjes publike.

Gjatë vitit 2024, Komuna kishte ndarë subvencione në vlerë prej 180,000€ për klube sportive dhe federata.¹ Financimi ishte miratuar vetëm përmes vendimeve të Kuvendit Komunal, pa shpallur thirrje publike dhe pa lidhur marrëveshje me përfituesit, në të cilat do të përcaktoheshin të drejtat, detyrimet, qëllimi i financimit, afatet e zbatimit dhe mënyra e raportimit. Gjatë shqyrtimit të ligjshmërisë së këtyre akteve, Ministria e Financave Punës dhe Transfereve kishte konfirmuar se organizatat përfituese ishin të regjistruara si OJQ dhe se ndarja e subvencioneve duhej të realizohej në përputhje me Rregulloren MF Nr. 04/2017, pavarësisht se vendimet ishin marrë nga Kuvendi Komunal. Ministria kishte vlerësuar se aktet komunale ishin në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Ndërsa në vitin 2025, komuna kishte financuar Federatën e Futbollit të Kosovës, me status të OJQ-së, në vlerë prej 40,000€ për realizimin e projektit “Liga e shkollave të Prishtinës”. Për këtë qëllim, Kryetari i Komunës kishte lidhur marrëveshje bashkëfinancimi më 29.04.2025. Megjithatë, dokumentacioni në dispozicion nuk përmbante dëshmi se përfituesi kishte paraqitur kërkesë, se projekti ishte shqyrtuar dhe vlerësuar sipas kriterëve të përcaktuara, apo se ishte zhvilluar procedurë e thirrjes publike për përzgjedhjen e tij. Kjo çështje është paraqitur edhe në raportin e auditimit të PVF-ve të Komunës për vitin 2025.

Shkaku:

Kjo gjendje ishte pasojë e interpretimit të gabuar se subvencionet e miratuara me vendim të Kuvendit Komunal nuk i nënshtroheshin procedurave të përcaktuara me Rregulloren MF Nr. 04/2017, si dhe e mungesës së një shqyrtimi të plotë ligjor dhe procedural para miratimit të vendimeve.

Ndikimi :

Ndarja e subvencioneve pa thirrje publike dëmton transparencën dhe konkurrencën, duke përjashtuar OJQ-të e tjera nga mundësia për të aplikuar në mënyrë të barabartë. Për më tepër, mungesa e një marrëveshjeje të nënshkruar para pagesës rrezikon që përfituesi të mos jetë i obliguar ligjërisht për përmbushjen e qëllimeve dhe kushteve të financimit, çka mund të ndikojë negativisht në menaxhimin e mjeteve publike.

¹ Përfituesit ishin: 3X3 Prishtina - 40,000€; K.H. Prishtina - 30,000€; KB Sigal Prishtina - 50,000€; KV Prishtina - 10,000€; Federata e Hendbollit të Kosovës - 10,000€; Klubi i Futsallit Prishtina 01 - 20,000€; dhe KBF Prishtina - 20,000€.

Rekomandimi:

Kryetari duhet të sigurojë se me rastin e mbështetjes financiare ndaj OJQ-ve, të aplikohen thirrjet publike sipas kërkesave të rregullores në fuqi. Gjithashtu, të sigurohet se nënshkrimi i marrëveshjes mes komunës dhe përfituesit, të bëhet para pagesës së mjeteve.

Çështja 3 - Përfitimi i subvencioneve pa përmbushjen e kriterëve të përcaktuara

Kriteri:

Në thirrjen publike me Nr. 16-030/08-59830/24, të datës 24.04.2024, si dhe në thirrjen publike Nr. 16-016/01-617191/25, të datës 15.05.2025, për ofrimin e mbështetjes financiare publike për projekt-propozimet e klubeve sportive, shoqatave dhe OJQ-ve për organizimin e aktiviteteve sportive në Komunën e Prishtinës, ishte përcaktuar dokumentacioni i detyrueshëm që duhej të dorëzohej nga aplikuesit, i cili ndër të tjera përfshinte: vërtetimin nga ATK-ja se OJQ-ja, klubi apo shoqata nuk kishte obligime tatimore si dhe deklaratën për financim të dyfishtë. Ndërsa sipas nenit 6, paragrafit 4 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve nga Komuna e Prishtinës, përfituesi i cili, për shkak të papërgjegjësisë së tij, nuk i përmbush obligimet e përcaktuara në marrëveshjen për subvencionim, humb të drejtën për të përfituar nga çdo kategori e subvencioneve për tre vitet pasuese.

Gjendja:

Nga auditimi i mostrave u identifikuan mangësitë si në vijim:

- në katër raste mungonte vërtetimi nga ATK-ja për mungesën e obligimeve tatimore;
- në katër raste mungonte deklarata për financim të dyfishtë; dhe
- në dy raste, përfituesit nuk i kishin përmbushur obligimet e raportimit dhe të ofrimit të dëshmive për subvencionet e përfituara në vitin paraprak, megjithatë ishin përfitues të subvencioneve.

Shkak:

Kjo kishte ndodhur për shkak të kontrolleve të mangëta dhe mungesës së përgjegjësisë nga komisioni i vlerësimit për zbatimin e kriterëve të vendosura në thirrjet publike.

Ndikimi:

Mos respektimi i kriterëve të përcaktuara në thirrjen publike me rastin e subvencionimit rrezikon transparencën gjatë procesit dhe rezulton me përzgjedhjen jo të drejtë të përfituesve përkatësisht diskriminimin e aplikantëve që kanë plotësuar kriteret e thirrjes.

Rekomandimi :

Kryetari duhet të sigurojë vendosjen e një procesi të plotë dhe të dokumentuar të verifikimit, në mënyrë që financimi të aprovohet vetëm për aplikuesit që plotësojnë kriteret dhe kanë përmbushur obligimet nga subvencionet e mëparshme.

Çështja 4 - Vonesa në zhvillimin e procedurave dhe në procedimin e pagesave për projektet e subvencionuara

Kriteri:

Neni 8 paragrafi 5, i Rregullores MF nr. 04/2017 përcakton se, Komisioni Vlerësues duhet të themelohet gjatë kohës sa thirrja publike është e hapur, ndërsa sipas nenit 8 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve nga Komuna e Prishtinës, komisioni bën shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve brenda afatit prej 30 ditësh pune pas përfundimit të afatit të shpalljes publike dhe vepron në pajtim me legjislacionin për financat publike, dispozitat e kësaj rregulloreje dhe legjislacionin në fuqi. Thirrja publike për vitin 2025 përcaktonte se periudha e zbatimit të projekteve ishte deri më 31 mars 2026 për klubet sportive, ndërsa deri më 30 nëntor 2025 për OJQ-të rinore dhe projektet sportive.

Gjendja:

Komuna e Prishtinës, më 16.05.2025, kishte shpallur thirrjen publike për subvencionimin e projekteve në fushën e sportit dhe rinisë. Megjithatë, gjatë zhvillimit të procesit nuk ishin respektuar afatet e përcaktuara ligjore dhe procedurale, si në vijim:

- Komisioni Vlerësues ishte formuar më 13.06.2025, përkatësisht 14 ditë pas mbylljes së thirrjes, dhe jo gjatë periudhës sa thirrja ishte e hapur;
- Raporti përfundimtar i vlerësimit ishte hartuar më 20.08.2025, përkatësisht 82 ditë kalendarike pas mbylljes së thirrjes, duke tejkaluar afatin e përcaktuar prej 30 ditësh pune. Ndërsa raporti ishte aprovuar më 03.09.2025, 14 ditë pas hartimit të tij dhe 96 ditë kalendarike pas mbylljes së thirrjes.
- Për pagesë ishin proceduar vetëm 30 përfitues, në vlerë prej 98,980€, ndonëse Komisioni Vlerësues kishte propozuar për financim 188 përfitues, në vlerë prej 599,961€. Procedimi ishte bërë më 22.12.2025, pas përfundimit të afatit të zbatimit për OJQ-të rinore dhe projektet sportive, i cili kishte përfunduar më 30.11.2025, ndërsa për klubet sportive kishte mbetur një periudhë e kufizuar deri më 31.03.2026.

Shkaku:

Kjo gjendje ishte për shkak të planifikimit jo të duhur të procesit dhe dobësive në kontrollet e brendshme për respektimin e afateve. Ndërsa mosrealizimi i pagesave për pjesën më të madhe të përfituesve ishte ndikuar edhe nga mungesa e mjeteve buxhetore në dispozicion, pasi një pjesë e buxhetit të kategorisë së subvencioneve ishte ekzekutuar nga Thesari në bazë të vendimeve gjyqësore dhe përmbarimore.

Ndikimi:

Mosrespektimi i afateve ligjore dhe procedurale ka ndikuar në zgjatjen e procesit të ndarjes së subvencioneve dhe në vonesën e mbështetjes financiare për përfituesit. Kjo ka kufizuar kohën efektive për zbatimin e projekteve, ka krijuar pasiguri për realizimin e aktiviteteve të planifikuara dhe rrit rrezikun që objektivat e projekteve të mos arrihen brenda periudhave të përcaktuara.

Rekomandimi :

Kryetari duhet të sigurojë respektimin e afateve ligjore gjatë zhvillimit të thirrjeve publike dhe procedimit të pagesave, në mënyrë që projektet të realizohen brenda afateve të përcaktuara.

Çështja 5 - Mangësi në monitorimin dhe raportimin e subvencioneve

Kriteri:

Në bazë të Rregullores MF Nr. 04/2017 për kriteret, standardet dhe procedurat për financimin publik të OJQ-ve, neni 23 përcakton se përfituesi i grantit/subvencionit është i obliguar të raportojë te zyrtari monitorues për zbatimin e projektit në përputhje me kontratën. Raportimi përfshin raportin narrativ dhe financiar, ndërsa afatet dhe mënyra e raportimit përcaktohen në marrëveshjen e nënshkruar me përfituesin. Po ashtu, kontrata në mes përfituesit dhe Komunës neni 4, paragrafi 4 përcakton se "Përfituesi duhet t'ia sjell Komunës raportin narrativ për punën e kryer sipas projektit dhe raportin financiar për mjetet e shpenzuara, me dokumentacionin përcjellës financiar, në afat 30 ditë prej realizimit të projektit (sipas udhëzuesit së bashkangjitur në kontratë). Ndërsa, sipas Manualit për Implementimin e Rregullores MF-Nr. 04/2017, raportimi nga përfituesit duhet të bëhet përmes formularëve standardë: Formularit F17 për raportin narrativ dhe Formularit F18 për raportin financiar.

Gjendja:

Gjatë auditimit identifikuar mangësi në procesin e monitorimit dhe verifikimit të realizimit të projekteve të subvencionuara, si në vijim:

- Komuna nuk kishte caktuar zyrtarë përgjegjës ose ekip monitorues për monitorimin e zbatimit të projekteve të financuara përmes subvencioneve. Si rezultat, nuk kishte dëshmi se ishte kryer monitorimi i aktiviteteve të realizuara dhe i përdorimit të mjeteve financiare në përputhje me qëllimin e përcaktuar në kontrata.
- në 13 raste, përfituesit nuk kishin dorëzuar raportet narrative dhe financiare për realizimin e projektit;
- në nëntë raste, raportimi nuk ishte bërë përmes formularëve standardë F17 dhe F18, siç kërkohet me Manual; dhe
- në tri raste, dëshmitë e ofruara për shpenzimet nuk përputheshin me kategoritë, aktivitetet ose vlerat e përcaktuara në buxhetin e financiar dhe të aprovuar.

Shkak:

Kjo kishte ndodhur për shkak të moszbatimit të kërkesave ligjore, mungesës së përcaktimit të përgjegjësive për monitorim dhe mungesës së mekanizmave për përcjelljen e raportimit nga përfituesit.

Ndikimi:

Mangësitë në monitorim dhe raportim rrisin rrezikun që mjetet publike të mos përdoren në përputhje me qëllimet dhe buxhetin e aprovuar, si dhe kufizojnë mundësinë e Komunës për të vlerësuar realizimin e aktiviteteve dhe arritjen e objektivave në fushën e sportit. Po ashtu, kjo dobëson transparencën dhe llogaridhënien në menaxhimin e subvencioneve.

Rekomandimi :

Kryetari duhet të sigurojë që, për secilën kontratë të subvencionimit, të caktohet zyrtari përgjegjës ose ekipi monitorues, të dokumentohen aktivitetet e monitorimit dhe të kërkohet nga përfituesit dorëzimi në kohë i raporteve financiare dhe narrative, së bashku me dëshmitë përkatëse. Në rast të mosrespektimit të detyrimeve kontraktuale, Komuna duhet të ndër marrë masat e përcaktuara në kontratë dhe në rregulloret përkatëse.

PJESA IV. KONKLuzionET

Bazuar në gjetjet e auditimit, konkludojmë se Komuna e Prishtinës nuk ishte në pajtueshmëri të plotë me kërkesat ligjore, procedurale dhe kontraktuale për menaxhimin e subvencioneve në fushën e sportit dhe rinisë.

Mangësitë kishin të bënin me zhvillimin e procedurave pa kritere dhe metodologji të standardizuar të vlerësimit, si dhe mosrespektimin e afateve për vlerësimin dhe procedimin e pagesave. Po ashtu, subvencione ishin ndarë pa thirrje publike dhe për aplikues që nuk i kishin plotësuar të gjitha kriteret.

Dobësi ishin evidentuar edhe në monitorimin dhe raportimin e projekteve, pasi nuk ishin caktuar zyrtarë monitorues, mungonin raportet narrative dhe financiare, ndërsa në disa raste shpenzimet nuk përputheshin me buxhetet e aprovuara.

Këto mangësi rrisin rrezikun që përfituesit të mos përzgjidhen në mënyrë transparente dhe të barabartë, që mjetet të mos përdoren sipas qëllimit dhe që objektivat e financimit të mos arrihen.

PJESA V. REKOMANDIMET

Rekomandimet për Kryetarin e Komunës së Prishtinës:

- Të sigurojë respektimin e afateve ligjore për formimin e komisioneve, vlerësimin e aplikimeve dhe procedimin e pagesave.
- Të sigurojë që kriteret, prioritetet dhe metodologjia e vlerësimit të përcaktohen paraprakisht dhe të përdoren formularët standardë.
- Të sigurojë që subvencionet të ndahen përmes thirrjeve publike dhe marrëveshjet me përfituesit të nënshkruhen para pagesës.
- Të sigurojë verifikimin e plotë të dokumentacionit dhe financimin vetëm të aplikuesve që plotësojnë kriteret dhe obligimet nga subvencionet e mëparshme.
- Të caktojë zyrtarë përgjegjës për monitorimin dhe të sigurojë dorëzimin e raporteve narrative e financiare, së bashku me dëshmitë përkatëse dhe të ndërmarrë masa ndaj përfituesve që nuk i përmbushin obligimet kontraktuale ose që nuk arsyetojnë përdorimin e mjeteve.

PJESA VI. PËRGJIGJET NGA ENTITETI I AUDITUAR



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2024, 2025

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pajtueshmërisë të procesit të menaxhimit dhe monitorimit të subvencioneve në fushën e sportit për periudhën janar 2024 deri në dhjetor 2025 (në tekstin e mëtejme “Raporti”);
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit;
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t’ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Përparim Rama

Kryetari i Kryeqytetit

Data: 13.08.2026



Zyra Kombëtare e Auditimit
Lagjja Arbëria
Rr. Ahmet Krasniqi, 210
10000 Prishtina
Republika e Kosovës